



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal**  
**Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave**  
**Ministry of Local Government Administration**

<b>Për :</b>	<b>Xhafer Gashi</b> , Kryetar i Komunës së Obiliqit <b>Burim Gërguri</b> , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit	
<b>Kopje</b>	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
<b>Përmes:</b>	<b>Ivan Todosijević</b> , Ministër i MAPL-së <b>Rozafa Ukimeraj</b> , Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
<b>Nga:</b>	<b>Shkelqim Jakupi</b> , Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 30/05/2018 Nr. 020-621
<b>Lënda:</b>	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Obiliqit	
<b>Lloji i aktit:</b>	Rregullore e Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Rregullore Nr. 1-83 e Punës së Kuvendit të Komunës së Obiliqit
I miratuar më datë më datë: 22.05.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 25.05.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Rregullore Nr. 1-83 e Punës së Kuvendit të Komunës së Obiliqit	<p><b>Shkelja e evidentuar</b> – Përmbajtja VI. Të drejtat dhe përgjegjësit të këshilltarit. VI. Shuarja e mandatit të këshilltarit. IX. Grupet e këshilltarëve.</p> <p><b>Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë</b> - Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nuk e njeh emërtimin këshilltarë. Ky term të zëvendësohet me termin Anëtarë i Kuvendit të Komunës.</p> <p><b>Shkelja e evidentuar</b> - Neni 10.1, Neni 11.1, dhe 11.2 për këshilltarët e kuvendit;</p> <p><b>Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë</b> - Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nuk e njeh emërtimin këshilltarë. Ky term të zëvendësohet me termin Anëtarë i Kuvendit të Komunës.</p> <p><b>Shkelja e evidentuar</b> - Neni 14 pika b) një grup i këshilltarëve a po një këshilltarë.</p> <p><b>Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë</b> - Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nuk e njeh emërtimin këshilltarë. Ky term të zëvendësohet me termin Anëtarë i Kuvendit të Komunës.</p> <p><b>Shkelja e evidentuar</b> - Neni 25.3 Mbledhjen e Kuvendit mund ta thërret edhe shumica e këshilltarëve nga numri i përgjithshëm i përbërjes së kuvendit.</p> <p><b>Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë</b> - Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nuk e njeh emërtimin këshilltarë. Ky term të zëvendësohet me termin Anëtarë i Kuvendit të Komunës.</p> <p><b>Shkelja e evidentuar</b> - Neni 26.1 këshilltarët e kuvendit njoftohen në formë të shkruar së paku 7 (shtatë) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së</p>

rregullt dhe 3 (tre) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes urgjente.

**Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë** - Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nuk e njih emërtimin këshilltarë. Ky term të zëvendësohet me termin Anëtarë i Kuvendit të Komunës.

**Shkelja e evidentuar** - Neni 35.1 Grupet e këshilltarëve, këshilltarët dhe përfaqësuesit e trupave punues të kuvendit përkatësisht të komiteteve dhe komisioneve e kanë të drejtën të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës.

**Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë** - Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nuk e njih emërtimin këshilltarë. Ky term të zëvendësohet me termin Anëtarë i Kuvendit të Komunës.

**Shkelja e evidentuar** - Pyetja e këshilltarit, Neni 52.1, 52.2, Neni 53.1 Neni 53.3, Neni 53.4, Neni 54.1, Neni 54.2, dhe neni 55.3.

**Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë** - Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nuk e njih emërtimin këshilltarë. Ky term të zëvendësohet me termin Anëtarë i Kuvendit të Komunës.

**Shkelja e evidentuar** - Përgjigja në pyetjen e këshilltarit Neni 54.1, 54.2, Neni 57.2.

**Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë** - Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nuk e njih emërtimin këshilltarë. Ky term të zëvendësohet me termin Anëtarë i Kuvendit të Komunës.

**Shkelja e evidentuar** - Neni 59.1, Neni 60.1, Neni 60.2, Neni 60.3, Neni 60.4 dhe Neni 60.5.

**Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë** - Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nuk e njih emërtimin këshilltarë. Ky term të

zëvendësohet me termin Anëtarë i Kuvendit të Komunës.

**Shkelja e evidentuar** - Neni 62.3 Mbledhjen nga paragrafi paraprak i këtij neni e thërret këshilltari më i vjetër apo këshilltarin të cilin e cakton Kuvendi në mbledhjen kur konstatohet pushimi i mandatit të kryesuesit të kuvendit.

**Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë** - Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale përcakton se në rast të mungesës së kryesuesit të kuvendit të komunës, apo pushimit të mandatit të tij mbledhjet thirren nga anëtarë më i vjetër i kuvendit deri në zgjedhjen e kryesuesit.

**Shkelja e evidentuar** - Përgjegjësitë e këshilltarit Neni 65.1, Neni 65.2, Neni 65.3 dhe Neni 65.4. Mungesa e këshilltarit Neni 66.1, Neni 66.2, Neni 67.1, Neni 67.2 dhe Neni 68.1.

**Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë** - Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nuk e njeh emërtimin këshilltarë. Ky term të zëvendësohet me termin Anëtarë i Kuvendit të Komunës.

**Shkelja e evidentuar** - Neni 69.1 Këshilltarit i jepet kartela identifikuese, Neni 69.2, Neni 69.3 dhe Neni 69.4.

**Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë** - Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nuk e njeh emërtimin këshilltarë. Ky term të zëvendësohet me termin Anëtarë i Kuvendit të Komunës.

**Shkelja e evidentuar** - Shuarja e mandatit të këshilltarit Neni 70.1, Neni 70.2, Neni 71.1, Neni 71.2 , Neni 72.1, Neni 72.3, Neni 73.1, Neni 73.2, dhe Neni 73.3.

**Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë** - Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nuk e njeh emërtimin këshilltarë. Ky term të zëvendësohet me termin Anëtarë i Kuvendit të Komunës.

**Shkelja e evidentuar** - Grupet e këshilltarëve dhe përfaqësimi politik Neni 74.1, Neni 74.2, Neni 74.3, Neni 74.4, Neni 74.5, Neni 74.6, Neni 74.7, Neni 74.8, Neni 74.9, Neni 75.1, Neni 75.2, Neni 76.3, 79.1 dhe Neni 79.2.

**Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë** - Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nuk e njeh emërtimin këshilltarë. Ky term të zëvendësohet me termin Anëtarë i Kuvendit të Komunës.

**Shkelja e evidentuar** - Shërbimi profesional i kuvendit, Neni 93.1, Neni 94.1, Neni 95.1

**Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë** - Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nuk e njeh emërtimin këshilltarë. Ky term të zëvendësohet me termin Anëtarë i Kuvendit të Komunës.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

<b>Za :</b>	Xhafer Gashi, gradonačelnik Opštine Obilić Burim Gërguri, predsedavajući Skupštine opštine Obilić	
<b>Kopija</b>	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jednici za administraciju dokumenata u opštini	
<b>Preko:</b>	Ivan Todosijević, ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u	
<b>Od:</b>	Shkelqim Jakupi, rukovodilac Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština	Datum, 30.05.2018. Br. 020-621
<b>Predmet:</b>	Zahtev za ponovno razmatranje odluke skupštine opštine	
<b>Vrsta akta:</b>	Odluka	

Poštovani gradonačelnice,  
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Uredba br. 1-83 o radu Skupštine opštine Obilić
Usvojena dana, 22.05.2018. godine
Predložana za razmatranje u MALS-u dana, 25.05.2018. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da opštinski akt nije u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

Br.	Formulisanje u aktu opštine	Zakonske odredbe sa kojima je akt opštine u suprotnosti.
1.	Uredba br. 1-83 o radu Skupštine opštine Obilić	<p><b>Evidentirano kršenje</b> – sadržaj VI. Prava i odgovornosti savetnika. VI. prestanak savetnikovog mandata. IX. grupa svetnika .</p> <p><b>Zahtev za reviziju zakonitosti - Zakon br. 03/L-040</b> o lokalnoj samoupravi ne poznaje imenovanje (ime) svetnika. Ovaj mandat se zamenjuje sa mandatom člana Skupštine opštine.</p> <p><b>Evidentirano kršenje</b> – član 10.1, član 11.1, i 11.2 za savetnike skupštine;</p> <p><b>Zahtev za reviziju zakonitosti - Zakon br. 03/L-040</b> o lokalnoj samoupravi ne poznaje imenovanje (ime) svetnika. Ovaj mandat se zamenjuje sa mandatom člana Skupštine opštine.</p> <p><b>Evidentirano kršenje</b> – član 14 tačka (b) jedna grupa savetnika ili jedan savetnik.</p> <p><b>Zahtev za reviziju zakonitosti - Zakon br. 03/L-040</b> o lokalnoj samoupravi ne poznaje imenovanje (ime) svetnika. Ovaj mandat se zamenjuje sa mandatom člana Skupštine opštine.</p> <p><b>Evidentirano kršenje</b> – Neni 25.3 sednicu Skupštine može sazivati i većina savetnika od ukupnog broja sastava skupštine.</p> <p><b>Zahtev za reviziju zakonitosti - Zakon br. 03/L-040</b> o lokalnoj samoupravi ne poznaje imenovanje (ime) svetnika. Ovaj mandat se zamenjuje sa mandatom člana Skupštine opštine.</p> <p><b>Evidentirano kršenje</b> – član 26.1 savetnici se pismenim putem obaveštavaju sadam (7) radnih dana pre održavanja redovne sednice i tri (3) radna dana pre održavanja urgentne sednice.</p>

**Zahtev za reviziju zakonitosti - Zakon br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi ne poznaje imenovanje (ime) svetnika. Ovaj mandat se zamenjuje sa mandatom člana Skupštine opštine.**

**Evidentirano kršenje - član 35.1 grupe savetnika, savetnici i predstavnici radnih tela, odnosno komisija i odbora imaju pravo da predlažu dopunu i izmenu dnevnog reda.**

**Zahtev za reviziju zakonitosti - Zakon br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi ne poznaje imenovanje (ime) svetnika. Ovaj mandat se zamenjuje sa mandatom člana Skupštine opštine.**

**Evidentirano kršenje - pitanje savetnika, član 52.1, 52.2, član 53.1 član 53.3, član 53.4, član 54.1, član 54.2, i član 55.3 mandata savetnika.**

**Zahtev za reviziju zakonitosti - Zakon br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi ne poznaje imenovanje (ime) svetnika. Ovaj mandat se zamenjuje sa mandatom člana Skupštine opštine.**

**Evidentirano kršenje - odgovor na pitanje savetnika član 54.1, 54.2, član 57.2.**

**Zahtev za reviziju zakonitosti - Zakon br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi ne poznaje imenovanje (ime) svetnika. Ovaj mandat se zamenjuje sa mandatom člana Skupštine opštine.**

**Evidentirano kršenje - član 59.1, član 60.1, član 60.2, član 60.3, član 60.4 i član 60.5.**

**Zahtev za reviziju zakonitosti - Zakon br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi ne poznaje imenovanje (ime) svetnika. Ovaj mandat se zamenjuje sa mandatom člana Skupštine opštine.**

**Evidentirano kršenje - član 62.3 sednicu sa prethodnog stava ovog člana poziva najstariji svetnik koga određuje skupština na sednici kada se utvrđuje prestanak mandata predsedavajućeg Skupštine opštine.**



**Zahtev za reviziju zakonitosti - Zakon br . 03/L-040 o lokalnoj samoupravi u slučaju odsutnosti predsjedavajućeg Skupštine opštine ili prestanka njegovog mandata, sednice se sazivaju od strane najstarijeg člana skupštine do izbora novog predsjedavajućeg.**

**Evidentirano kršenje - odgovornosti savetnika, član 65.1, član 65.2, član 65.3 i član 65.4. nedostatak savetnika, član 66.1, član 66.2, član 67.1, član 67.2 i član 68.1.**

**Zahtev za reviziju zakonitosti - Zakon br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi ne poznaje imenovanje (ime) svetnika. Ovaj mandat se zamenjuje sa mandatom člana Skupštine opštine.**

**Evidentirano kršenje - član 69.1 savetniku sa izdaje kartica za identifikovanje, član 69.2, član 69.3 i član 69.4.**

**Zahtev za reviziju zakonitosti**

**- Zakon br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi ne poznaje imenovanje (ime) svetnika. Ovaj mandat se zamenjuje sa mandatom člana Skupštine opštine.**

**Evidentirano kršenje - prestanak svatnikovog mandata, član 70.1, član 70.2, član 71.1, član 71.2 , član 72.1, član 72.3, član 73.1, član 73.2, i član 73.3.**

**Zahtev za reviziju zakonitosti - Zakon br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi ne poznaje imenovanje (ime) svetnika. Ovaj mandat se zamenjuje sa mandatom člana Skupštine opštine.**

**Evidentirano kršenje - grupa savetnika i političko predstavljanje, član 74.1, član 74.2, član 74.3, član 74.4, član 74.5. član 74.6, član 74.7, član 74.8, član 74.9, član 75.1, član 75.2, član 76.3, 79.1 i član 79.2.**

**Zahtev za reviziju zakonitosti Zakon br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi ne poznaje imenovanje (ime) svetnika. Ovaj mandat se zamenjuje sa mandatom člana Skupštine opštine.**



183 22.05.2018



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obiliq - Municipality Assembly Obiliq

	MINISTRIE E QYLLIMIT, BASHKIMISIA DHE PUNËVE TË BASHKËPUNËS MINISTRIE E QYLLIMIT, BASHKIMISIA DHE PUNËVE TË BASHKËPUNËS MINISTRIE E QYLLIMIT, BASHKIMISIA DHE PUNËVE TË BASHKËPUNËS
Administrata e Administrimit të Peshqarëve Lokalë Administrata e Lokaliteteve Bashkëpunuese / Administrata e Bashkëpunimit të Qytetit të Peshqarëve Lokalë 25.05.2018	
№	
№ i Dokumentit	№ i Kartës
-VI- 9-621	

# RREGULLORE E PUNËS E KUVENDIT TË KOMUNËS SË OBILIQIT

Obiliq  
22 Maj 2018

## Përmbajtja:

I. Dispozitat e përgjithshme.....	3
II. Konstituimi i Kuvendit.....	3
III. Mbledhjet e Kuvendit.....	7
IV. Rregullat për mbarëvajtjen e punës në mbledhje.....	15
V. Kompetencat dhe përgjegjësit e kryesuesit të Kuvendit.....	16
VI. Të drejtat dhe përgjegjësitë së këshilltarit.....	18
VII. Shuarja e mandatit të këshilltarit.....	19
VIII. Konflikti i interesit.....	19
IX. Grupet e këshilltarëve.....	20
X. Trupat punues të Kuvendit.....	20
XI. Programi i punës i Kuvendit.....	22
XII. Transparenca e punës së Kuvendit.....	23
XIII. Shërbimi profesional i Kuvendit.....	23
XIV. Dispozitat përfundimtare.....	24

Në bazë të nenit 12.2 nën pikën (c) dhe nenit 17 pika (s) të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr. 03/2014, Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe nenit 89 të Statutit të Komunës së Obiliqit, nr.1-34 të datës 25.04.2016, Kuvendi i Komunës së Obiliqit, në mbledhjen e mbajtur me \_\_\_\_\_ miratoi:

## **RREGULLORE TË PUNËS TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË OBILIQIT**

### **I. Dispozitat e përgjithshme**

#### **Neni 1**

1.1 Me këtë Rregullore, më afërsisht, përcaktohen rregullat e punës të Kuvendit të Komunës së Obiliqit, mënyrat e vendosjes, mënyrat e realizimit të të drejtave e përgjegjësiave të këshilltarëve, procedurat e pjesëmarrjes së qytetarëve në mbledhje dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e Kuvendit të Komunës, në tekstin e mëtejshëm Kuvendi.

#### **Neni 2**

2.1 Me këtë Rregullore, përcaktohet edhe mënyra e thirrjes, organizimit dhe mbajtjes së mbledhjeve: inauguruese, të rregullta, të jashtëzakonshme, urgjente dhe solemne, mirafimi i rendit të ditës, pjesëmarrja në diskutim dhe rregullat për mbarëvajtjen e punës së Kuvendit.

#### **Neni 3**

3.1 Kuvendi shqyrton dhe vendos çështje për të cilat është kompetent mbi bazën e dispozitave ligjore, Statutin e Komunës dhe dispozitave të tjera nënligjore si dhe çështje të cilat i delegohen nga Niveli qendror i Republikës së Kosovës.

#### **Neni 4**

4.1. Në punën e Kuvendit, gjuhët zyrtare të Komunës përdoren në mënyrë të barabartë.

### **II. Konstituimi i Kuvendit**

#### **1. Mbledhja inauguruese e Kuvendit**

## Neni 5

5.1 Mbledhjen inauguruuese të Kuvendit të Komunës e thërret Kryetari Komunës, atëherë kur është zgjedhur, brenda pesëmbëdhjet (15) ditësh nga data e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

5.2 Ftesa për Mbledhjen inauguruuese i dërgohet shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes anëtarëve të Kuvendit dhe autoriteteve mbikëqyrëse.

5.3 Në raste të veçanta ftesa mund të dërgohet tre (3) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.

5.4 Nëse kryetari i Komunës nuk e thërret mbledhjen sipa paragrafit 1 të këtij neni, mbledhjen e thërret anëtari më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit të Komunës, brenda pesëmbëdhjet (15) ditësh nga data kur kryetari është dashur të thirr mbledhjen inauguruuese të Kuvendit të Komunës.

5.5 Nëse anëtari më i vjetër i Kuvendit nuk e thërret mbledhjen inauguruuese të Kuvendit të Komunës, mbledhja thirret me iniciativën e shumicës së anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës.

## Neni 6

6.1 Në rast se kryesuesi i Kuvendit nuk zgjedhet në Mbledhjen inauguruuese, deri në zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit, mbledhjet i thërret dhe i kryeson këshilltari më i vjetër i Kuvendit.

## Neni 7

7.1 Rendi i ditës i mbledhjes inauguruuese, përveç tjerash, përmban:

- a) Hapja dhe kryesimi i mbledhjes nga këshilltari më i vjetër i Kuvendit
- b) Ngritja e Komisionit për verifikimin e mandatit të këshilltarëve të Kuvendit
- c) Raporti i Komisionit për verifikimin e mandatit të këshilltarëve të Kuvendit
- d) Dhënia dhe nënshkrimi i betimit solemn të këshilltarëve të Kuvendit
- e) Dhënia dhe nënshkrimi i betimit solemn të kryetarit të Komunës
- f) Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit
  - Ngritja e Komisionit për mbikëqyrjen e procesit të votimit
  - Propozimi i kandidatëve
  - Procesi i votimit
  - Raporti i Komisionit për rezultatet e votimit
- g) Dhënia dhe nënshkrimi i betimit solemn të kryesuesit të Kuvendit.

## Neni 8

8.1 Verifikimi i mandatit të këshilltarëve bëhet mbi bazën e vendimit për certifikim të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

## Neni 9

9.1 Betimi i këshilltarëve bëhet në ftesë të kryesuesit të mbledhjes së Kuvendit i cili e lexon pjesë pjesë tekstin, tekst që përsëritet në mënyrë të zëshme nga këshilltarët, me të vetmin ndryshim që pas fjalës unë çdo këshilltar e thotë emrin dhe mbiemrin e vet.

#### Neni 10

10.1 Teksti i betimit për këshilltarë është:

Unë \_\_\_\_\_, betohem (ose deklaroj solemnisht ) se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia në cilësinë e këshilltarit të Kuvendit të Komunës së Obiliqit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë qytetarët.

#### Neni 11

11.1 Këshilltari i Kuvendit të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me dispozita ligjore, Statutin e Komunës dhe këtë Rregullore i fiton ditën e verifikimit të mandatit përkatësisht ditën e dhënies dhe nënshkrimit të betimit solemn.

11.2 Betimi solemn nënshkruhet nga këshilltari dhe kryesuesi i mbledhjes, përkatësisht kryesuesi i Kuvendit dhe këshilltarët komunal

#### Neni 12

12.1 Kryetari i Komunës betimin solemn e jep pas konstituimit të Kuvendit.

12.2 Tekstin e betimit pjesë pjesë e lexon kryesuesi i mbledhjes, ndërsa kryetari i Komunës e përsëritë në mënyrë të zëshme.

12.3 Teksti i betimit për kryetar të Komunës është:

Unë \_\_\_\_\_, " betohem (ose deklaroj solemnisht ) se do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat e mia si Kryetar i Komunës së Obiliq, me nder, besnikëri, paanshmëri, ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

## 2. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit.

#### Neni 13

13.1 Kuvendi, në afat prej 30 ditësh nga dita e konstituimit, e zgjedhë kryesuesin nga radhët e këshilltarëve të Kuvendit.

13.2 Kryesuesi i Kuvendit zgjedhet për mandat të njëjtë të përbërjes së Kuvendit.

#### Neni 14

14.1 Kandidatët për kryesues të Kuvendit i propozojnë:

- a) Përfaqësuesit e subjekteve politike në kuadër të përbërjes së Kuvendit

b) Një grup i këshilltarëve apo një këshilltar

14.3 Propozimit i bashkëngjitet edhe deklarata apo pëlqimi i kandidatit se e pranon kandidaturën.

14.4 Propozimi i kandidatëve për kryesues të Kuvendit mund të bëhet edhe në formë gojore gjatë procesit të propozimit të kandidatëve.

Neni 15

15.1 Kryesuesi i mbledhjes, përmes Shërbimit profesional të Kuvendit, për këshilltarë, siguron kopje të mjaftueshme të të gjitha propozimeve të paraqitura në formë të shkruar për kryesues të Kuvendit.

Neni 16

16.1 Për propozimet e kandidatëve, para se të kalohet në procesin e votimit, hapet debati.

16.2 Përfaqësuesi i propozuesve apo propozuesi, gjatë debatit, mund të paraqet arsyetime shtesë për propozimin e kandidatëve apo kandidatit.

Neni 17

17.1 Lista e fletëvotimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit, përpilohet sipas renditjes alfabetike të emrave të kandidatëve.

17.2 Votimi i kandidatëve për kryesues të Kuvendit bëhet me vota të fshehta.

Neni 18

18.1 Kandidati i cili në votimin e parë merr më shumë se gjysmën e votave nga numri i përgjithshëm i përbërjes së Kuvendit zgjedhet kryesues i Kuvendit.

18.2 Në rast se, asnjë prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e votave sipas paragrafit paraprak të këtij neni, në procesin e dytë të votimit përfshihen vetëm dy kandidatët të cilët në votimin paraprak kanë marrë numrin më të madh të votave

Neni 19

19.1 Në rast se edhe në votimin e dytë asnjëri prej kandidatëve nuk merr numër më të madh të votave se numri i përgjithshëm i përbërjes së Kuvendit, kalohet në votimin e tretë.

19.2 Në votimin e tretë, kryesues i Kuvendit zgjedhet kandidati i cili merr shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm në mbledhje.

19.3 Nëse kryesuesi i Kuvendit nuk zgjedhet edhe pas votimit të tretë i tërë procesi zgjedhor përsëritet deri në zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit.

#### Neni 20

20.1 Në tri proceset e votimit për kryesues të Kuvendit përdoren fletëvotime të ngjyrave të ndryshme.

20.2 Fletëvotimi përmban Emblemën zyrtare të Komunës, emërtimin për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit, kandidatët sipas radhës dhe nga një katror për deklarimin e votës në vijën horizontale të emrave dhe mbiemrave të kandidatëve, datën, vendin dhe vullën e Kuvendit.

20.3 Në rast se për kryesues të Kuvendit është vetëm një kandidat, përveç elementeve të përcaktuara në nenin paraprak, në fletëvotim shënohet emri dhe mbiemri i kandidatit dhe në vijën horizontale dy katror mbi të cilët shënohet "për" dhe "kundër" për deklarimin e votës së këshilltarëve.

#### Neni 21

21.1 Teksti i betimit për kryesues të Kuvendit është:

Unë \_\_\_\_\_, betohem se do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushroj kompetencat e mia në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Obiliqit, me nder, besnikëri, paanshmëri, ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

### III. Mbledhjet e Kuvendit

#### Neni 22

22.1 Kuvendi i Komunës mbanë mbledhje:

#### Neni 23

- 23.1. Mbledhje Inauguruese,
- 23.2. Mbledhje të rregullta
- 23.3. Mbledhje të jashtëzakonshme,
- 23.4. Mbledhje urgjente dhe
- 23.5. Mbledhje solemne.

#### Neni 24

24.1 Kuvendi gjatë një viti fiskal, është i obliguar të mbajë së paku 10 (dhjetë) prej të cilave 5 (pesë) mbledhje mbahen në gjashtëmuorin e parë të vitit përkatës fiskal.

### 1. Thirrja e mbledhjes

#### Neni 25

25.1 Mbledhjen e Kuvendit e thërret dhe e kryeson, kryesuesi i Kuvendit, në mungesë të Kryesuesit të Kuvendit, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i Kuvendit të Komunës.



25.2 Mbledhja urgjente thirret në rastet kur kryesuesi i Kuvendit e vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme por thirret edhe në kërkesë të kryetarit të Komunës si dhe në kërkesë të së paku 1/3 ( një të tretës ) të numrit të përgjithshëm të përbërjes së Kuvendit.

25.3 Mbledhjen e Kuvendit mund ta thërret edhe shumica e këshilltarëve nga numri i përgjithshëm i përbërjes së Kuvendit.

25.4 Mbledhja nga paragrafi paraparak i këtij neni thirret, në formë të shkruar, me propozim për shqyrtim të çështjeve konkrete dhe nënshkrim të këshilltarëve përkatës.

25.5 Rendi i ditës i mbledhjes urgjente, mbledhjes të thirrur nga shumica e këshilltarëve të përbërjes së Kuvendit dhe mbledhjes të thirrur në rrethana të jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohet gjatë mbledhjes.

#### Neni 26

26.1 Këshilltarët e Kuvendit njoftohen në formë të shkruar së paku 7 (shtatë) ditë pune para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes, ndërkaq tri ditë pune para mbajtjes së mbledhjes urgjente.

26.2 Thirrja për mbledhje, përveç tjerash, përmban

- a) Data e mbajtjes së mbledhjes
- b) Koha e fillimit të punës së mbledhjes
- c) Vendi i mbajtjes së mbledhjes
- d) Rendi i propozuar i ditës
- e) Materialet e propozuara për shqyrtim, dhe
- f) Çështje të tjera me rëndësi për mbledhjen përkatëse.

#### Neni 27

27.1 Materialet, në mënyrën dhe afatin e përcaktuar në nenin paraparak të kësaj Rregulloreje i dërgohen edhe Kryetarit të Komunës, drejtorëve të Drejtorive të Komunës dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal etj.

#### Neni 28

28.1 Kryesuesi i Kuvendit mund të vendosë që materiali i mbledhjeve të Kuvendit t'i dërgohet edhe mjeteve të informimit, grupeve të caktuara të interesit dhe subjekteve tjera të interesuara.

#### Neni 29

29.1 Kryesuesi i Kuvendit, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit i njofton edhe qytetarët në afatet e parapara në nenin 27.1 të kësaj Rregulloreje.

29.2 Njoftimi për mbajtjen e mbledhjeve, përveç tjerash, bëhet përmes :

- a) Tabelës së shpalljeve dhe shpalljeve publike,
- b) Mjeteve lokale të informimit, elektronike dhe të shkruara, dhe

c) Web faqes zyrtare të Komunës.

#### Neni 30

30.1 Për thirrjen e mbledhjeve në rrethana të jashtëzakonshme dhe nuk vlejnë mënyrat dhe afatet për thirrjen e mbledhjeve sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje por UA (MAPL) Nr.02/2015 .Neni 6 .

### 2. Hapja e mbledhjes

#### Neni 31

31.1 Mbledhjen e Kuvendit e hap dhe e udhëhedë kryesuesi i Kuvendit.

31.2 Kryesuesi i Kuvendit, përveç tjerash, njofton nëse ndonjë prej këshilltarëve paraprakisht e ka paralajmëruar mungesën për mbledhjen përkatëse të Kuvendit.

### 3. Kuorumi

#### Neni 32

32.1 Mbi bazën e thirrjes emër për emër të këshilltarëve verifikohet kuorumi për vendimmarrje në mbledhjen përkatëse të Kuvendit.

32.2 Kuorumi ekziston nëse në mbledhje janë të pranishëm 50% +1 këshilltar nga numri i përgjithshëm i përbërjes së Kuvendit.

32.3 Në rast se gjatë mbajtjes së mbledhjes, kryesuesi i Kuvendit, konstaton se nuk ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje e ndërpre në mbledhjen dhe e cakton kohën e fillimit të vazhdimit të mbledhjes.

32.4 Pas çdo pauze, para se të fillohet me punë, verifikohet prezenca përkatësisht numri i këshilltarëve të pranishëm në mbledhje.

### 4. Miratimi i rendit të ditës

#### Neni 33

33.1 Kryesuesi i Kuvendit njofton dhe jep sqarime të shkurtra për çështjet e përfshira në rendin e propozuar të ditës.

33.2 Kryesuesi i Kuvendit dhe kryetari i Komunës mund të propozojnë që në rend dite të përfshihen edhe çështje të tjera për të cilat në mënyrë urgjente është shtruar nevoja për shqyrtim pas dërgimit të thirrjes përkatësisht rendit të propozuar të ditës dhe materialit për mbledhjen përkatëse.

#### Neni 34

34.1 Komiteti për Politikë dhe Financa, mbi bazën e konstatimeve të miratuara, mund t'i rekomandojë Kuvendit që ndonjë çështje të hiqet nga rendi i ditës apo rendi i ditës të plotësohet me ndonjë çështje konkrete, me arsyetim të rekomandimit përkatës.

#### Neni 35

35.1 Grupet e këshilltarëve, këshilltarët dhe përfaqësuesit e trupave punues të Kuvendit përkatësisht Komitetëve dhe Komisioneve e kanë të drejtën të propozojnë ndryshimin apo plotësimin e rendit të ditës me arsyetim të shkurt të propozimit të paraqitur.

#### Neni 36

36.1 Propozimet për ndryshimin apo plotësimin e rendit të ditës, në parim, bëhen në formë të shkruar dhe i dërgohen kryesuesit të Kuvendit më së voni deri në fillim të mbledhjes.

36.2 Kuvendi vendos veç e veç për çdo propozim për ndryshimin apo plotësimin e rendit të ditës.

36.3 Së pari, sipas radhës së paraqitur, shqyrtohen propozimet që ndonjë çështje e propozuar të hiqet nga rendi i ditës.

36.4 Propozimet për plotësimin e rendit të ditës bëhen në analogji sipas mënyrës së përcaktuar në paragrafin paraprak të këtij neni.

#### Neni 37

37.1 Për propozimet lidhur me ndryshimin apo plotësimin e rendit të ditës nuk hapet debat, por pas arsyetimeve të shkurta të propozuesit dhe sqarimeve të kryesuesit të Kuvendit, përfaqësuesit të Ekzekutivit apo propozuesit të çështjes konkrete, kalohet në votim.

37.2 Rendi i propozuar i ditës, në tërësi, miratohet me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm në mbledhje.

### 5. Shqyrtimi i çështjeve në mbledhje të Kuvendit

#### Neni 38

38.1 Në mbledhje të Kuvendit çështjet shqyrtohen sipas radhës së përcaktuar në rendin e miratuar të ditës.

38.2 Sipas nevojës, në propozim të kryesuesit të Kuvendit, shefit të Grupit të këshilltarëve, apo këshilltarit, Kuvendi përmes votimit mund të vendos për bashkimin e dy apo më shumë çështjeve për shqyrtim të njëkohshëm apo ndryshimin e radhës për shqyrtimin e çështjeve përkatëse.

#### Neni 39

39.1 Këshilltarëve të Kuvendit, në parim, para fillimit të mbledhjeve në formë të shkruar iu dorëzohen Konstatimet përkatësisht rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa lidhur me çështjet e propozuara për shqyrtim në mbledhjet përkatëse të Kuvendit si dhe rekomandimet e trupave të tjerë punues të Kuvendit të cilat paraprakisht shqyrtohen në Komitetin për Politikë dhe Financa.

## 6. Debatë gjatë shqyrtimit të çështjeve

### Neni 40

40.1 Kryesuesi i Kuvendit është i obliguar që të respektojë parimin e të drejtës së barabartë për diskutim dhe pjesëmarrje aktive të këshilltarëve në punën e Kuvendit.

40.2 Kryesuesi i Kuvendit, të interesuarve fjalën ua jep sipas radhës së paraqitjes për diskutim.

40.3 Pjesëmarrësit në mbledhje për pika të caktuara në kuadër të rendit të ditës, për diskutim mund të paraqiten edhe para fillimit të mbledhjes. Evidencën e radhës së paraqitjes për diskutim para fillimit të mbledhjes e mban zyrtari i autorizuar i Shërbimit profesional të Kuvendit.

### Neni 41

41.1 Për çdo çështje, në kuadër të rendit të ditës, paraprakisht jepet fjala hyrëse nga propozuesi i çështjes konkrete në kohëzgjatje deri 10 minuta.

41.2 Pas fjalës hyrëse, kryesuesi i Kuvendit, fillimisht fjalën ua jep shefave të Grupeve të këshilltarëve, në kohëzgjatje deri 10 minuta, më pas tuj fjalë iu jepet këshilltarëve përkatësisht pjesëmarrësve të tjerë në kohëzgjatje deri 5 minuta.

41.3 Kuvendi, në fillim të shqyrtimit të ndonjë çështjeje, varësisht prej rëndësisë së saj, mund të ndryshojë kohëzgjatjen e diskutimit të paraparë në paragrafin paraprak të këtij neni.

41.4 Sqarimet plotësuese apo diskutimi për herë të dytë, në kuadër të një pike të rendit të ditës, lejohet vetëm pas përfundimit të të gjithë të paraqiturve për diskutim dhe atë në kohëzgjatje deri 3 minuta.


### Neni 42

42.1 Shefit të Grupit të këshilltarëve apo këshilltarit i cili e kërkon fjalën lidhur me shkeljen e dispozitave të kësaj Rregulloreje, fjala i jepet menjëherë.

### Neni 43

43.1 Gjatë shqyrtimit të një çështjeje apo propozimi konkret nuk lejohen propozime të tjera, përveç :

- a) Propozimit për ndryshime dhe modifikime.
- b) Propozimit për të parandaluar rregullimin e punës së mbledhjes.
- c) Propozimit që çështja konkrete të kompletohet me të dhëna shtesë dhe çështja të shtyhet për shqyrtim për mbledhje të radhës të Kuvendit.
- d) Propozimit që debati i mëtejshëm apo vazhdimi i mbledhjes të mbahet i mbyllur.
- e) Propozimit për ndërprerjen e debatit dhe vendosjen e çështjes përmes votimit.
- f) Propozimit për ndërprerje të mbledhjes.



#### Neni 44

44.1 Në rast se gjatë debatit përmendet në mënyrë të drejtpërdrejtë emri i ndonjë diskutuesi, është e lejuar replika në kohëzgjatje deri 3 minuta.

44.2 Replika ndaj replikës është e lejuar në kohëzgjatje deri 2 minuta.

44.3 Replika vijuese nuk është e lejuar përveç rasteve nëse kryesuesi Kuvendit e vlerëson të arsyeshme dhe të njëjtën e lejon dhe atë në kohëzgjatje deri 1 minuta.

#### Neni 45

45.1 Kryesuesi i Kuvendit, gjatë shqyrtimit të çështjeve, sipas vlerësimit të tij apo mbi bazën e propozimeve, në rast se janë të nevojshme konsultimet në kuadër të Grupeve të këshilltarëve, konsultimet me propozuesin e çështjes për të cilën debatohet apo çfarëdo konsultimesh të tjera, mund ta ndërprejë përkohësisht mbledhjen dhe njëkohësisht e cakton kohën e vazhdimit të mbledhjes.

45.2 Në rast se kryesuesi i Kuvendit nuk e përkrah propozimin për ndërprerjen e përkohshme të mbledhjes, për propozimin e dhënë Kuvendi vendos me votim, përkatësisht shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.

#### Neni 46

46.1 Përfaqësuesit e organeve, dhe Drejtorive të Administratës Publike të Komunës, përkatësisht propozuesve të materialeve, për çështjet e shtruarra gjatë debatit, sqarimet plotësuese i paraqesin pas përfundimit të diskutimeve të të gjithë të paraqiturve për diskutim.

### 7. Korumi dhe Votimi (Vendosja dhe miratimi i çështjeve)

#### Neni 47

47.1 Kuvendi çështjet i vendos dhe i miraton në mbledhje në të cilat ekziston kuorumi me shumicën e votave të këshilltarëve (1/2) të pranishëm. ( neni 46 i LVL n.031-040 ) nëse me dispozita ligjore, Statutin e Komunës dhe këtë Rregullore nuk është paraparë ndryshe.

47.2 Searca e kuvendit ndërpritet , nëse numri i këshilltarëve të pranishëm në sallë bie nën një të dytën (1/2) e numrit të përgjithshëm.

47.2 Votimi, në parim është i hapur përveç për çështjet e caktuara me dispozita ligjore, Statutin e Komunës dhe këtë Rregullore.

47.3 Votimi i hapur bëhet me ngritje të dorës

a) Votimi i thjeshtë " për " -" kundër " -" apsterim "

b) për mes votimi të regjistruar

zhirrja e secilit anëtar veç e veç ose votim elektronik ( kur të ofrohet ky shërbim në komunën e Obiliqit )

c) Votim i regjistruar , bëhet kur këtë e kërkon Kryesuesi i Kuvendit ose një grup i këshilltarëve të pranishëm ( vota regjistrohet " për " –" kundër " dhe " apstenim " do të regjistrohet me emër )

d) votimi elektronik ( kur të ofrohet ky shërbim në komunën e Obiliqit )

e ) votimi i fshehtë ( i paraparë edhe me nenin 48 )

47.4 Në rastë të numrit të barabartë të votave të hedhura " për " ose " kundë " të ndonjë propozimi , Kryesuesi i Kuvendit ka një votë shtesë ( neni 48 i LVL 03L-040 )

47.5 Në procesin e votimit, e drejtë personale e këshilltarit është që çështjen e caktuar ta përkrah, të jetë kundër ose të përmbahet.

#### Neni 48

48.1 Kuvendi, mbi bazën e propozimit të kryesuesit të Kuvendit apo këshilltarit, mund të vendos që për një çështje konkrete votimi të bëhet në mënyrë të fshehtë.

48.2 Në rast se votimi bëhet sipas paragrafit pararendës, paraprakisht ngritet Komisioni për mbikëqyrje dhe komunikim të rezultateve të votimit.

#### Neni 49

49.1 Në fund të debatit çështjet e shqyrtuara të rendit të ditës, kryesuesi i Kuvendit i përfundon me rezyme të shkurtë dhe konstatime mbi bazën e diskutimeve të zhvilluara dhe i paraqet rezultatet numerike të votimit përkatësisht konstaton se propozimi apo çështja konkrete a është miratuar apo nuk është miratuar.

### 8. Diskutimi publik

#### Neni 50

50.1 Aktet e përgjithshme dhe çështjet me rëndësi të veçantë, paraprakisht para miratimit vihen në diskutim publik.

50.2 Çështjet e obliguara për diskutim publik janë:

- a) Statuti i Komunës
- b) Strategjia e zhvillimit ekonomik
- c) Plan i zhvillimor komunal
- d) Plan i zhvillimor urban
- e) Plan i rregullues urban
- f) Plan i mbrojtjes së ambientit dhe mjedisit
- g) Transporti publik
- h) Furnizimi me ujë të pijes
- i) Rregulloret dhe vendimet me të cilat përcaktohen të drejtat dhe obligimet e qytetarëve.
- j) Bashkëfinancimi për realizimin e projekteve të ndryshme

- k) Rregullimi dhe mirëmbajtja e ambientit në lagje apo lokalitete të caktuara
- l) Krijimi i kushteve më të volitshme për rekreacion të qytetarëve në përgjithësi dhe rinisë në veçanti
- m) Çështje tjera të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë janë me ndikim në kushtet jetësore të qytetarëve
- n) Çështje tjera të përcaktuara me Statutin e Komunës, dhe
- o) Çështje për të cilat vendos Kuvendi i Komunës.

60.3 Për Statutin e Komunës, duke përfshirë edhe ndryshimet dhe plotësimet, kohëzgjatja e diskutimit publik është 30 ditë, për Strategjinë e zhvillimit ekonomik, Planin zhvillimor komunal, Planin zhvillimor urban, Planin rregullues urban dhe Planin për mbrojtjen e ambientit dhe mjedisit, diskutimi publik mbahet në kohëzgjatje prej 60 ditësh, ndërkaq për çështje të tjera prej 15 ditë deri në 30 ditë.

#### Neni 51

51.1 Varësisht nga natyra e çështjes, me vendim të veçantë, caktohet organi apo Drejtoria kompetente për zbatimin e diskutimit publik ku, përveç tjerash, përfshihet:

- a) Emërtimi i çështjes e cila është objekt i diskutimit publik.
- b) Vendi ku mbahet diskutimi publik.
- c) Kohëzgjatja e diskutimit publik.
- d) Të dhënat tjera të nevojshme që janë me ndikim për zbatimin e suksesshëm të diskutimit publik.
- e) Obligimi që në diskutim publik të merr pjesë përfaqësuesi i organit, Drejtorisë apo propozuesit të çështjes dhe ekspertë të tjerë të cilët mund të kontribuojnë në diskutim më të mirëfilltë, dhe
- f) Organi i cili e zbaton diskutimin publik është i obliguar të bëjë vlerësimin e propozimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna në aktin e propozuar, të jap sqarime përkatëse dhe të bëjë raport për zbatimin e diskutimit publik të cilin ia paraqet Kuvendit për shqyrtim.

#### 9. Pyetja e këshilltarit

##### Neni 52

52.1 Këshilltari e ka të drejtën që në mbledhje të Kuvendit t'i shtrojë pyetje kryesuesit të Kuvendit, kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të Drejtorive të Komunës për të gjitha çështjet në kompetencë të Komunës.

52.2 Pyetja e këshilltarit shtrohet në kuadër të pikës së rendit të ditës: Çështje të tjera.

##### Neni 53

53.1 Këshilltari, në një mbledhje, mund të shtrojë më së shumti dy pyetje.



53.2 Kohëzgjatja për një pyetje është deri 3 minuta.

53.3 Pyetja e këshilltarit paraqitet gojarisht dhe dorëzohet në formë të shkruar.

53.4 Për pyetjen e këshilltarit nuk hapet debat.

Neni 54

54.1 Përgjigjja në pyetjen e këshilltarit në parim, jepet në formë të shkruar para fillimit të mbledhjes së radhës të Kuvendit, por mund të jepet edhe menjëherë pas parashtrimit të pyetjes.

54.2 Lidhur me përgjigjen e dhënë, këshilltari i cili e ka shtruar pyetjen e ka të drejtën të shtrojë pyetje plotësuese në kohëzgjatje deri 3 minuta.

54.3 Përgjigjja mund të jepet menjëherë në formë gojore ose në formë të shkruar para fillimit të mbledhjes së radhës të Kuvendit.

## 10. Procesverbali

Neni 55

55.1 Për punën e Kuvendit mbahet ekstraktprocesverbali.

55.2 Mbi bazën e procesverbalit nxirret Ekstrakti i procesverbalit i cili, përveç tjerash, përmban datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, kohën e fillimit, emrin, mbiemrin dhe funksionin e udhëheqësit apo kryesuesit të mbledhjes, pjesëmarrësit, pikat e rendit të ditës, esenca e shkurt e diskutimeve me konstatimet përkatëse, rezultatet numerike të votimit për çështjet e shqyrtuara dhe kohën e mbarimit të mbledhjes.

55.3 Këshilltari, pjesëmarrës në mbledhje, ka të drejtë të kërkojë që diskutimi i tij apo një pjesë e diskutimit, në Ekstraktin e procesverbalit të evidentohet në formë të shkurtë në mënyrën në të cilën ai e paraqet çështjen konkrete.

55.4 Për plotësimin e kërkesës sipas paragrafit paraprak të këtij neni, këshilltari diskutimin e dorëzon në formë të shkruar.

55.5 Gjithashtu, Grupi i këshilltarëve apo këshilltari mund të kërkojnë që në Ekstrakt të procesverbalit të evidentohet veçimi i tyre gjatë votimit në çështje të caktuara.

55.6 Lista e nënshkruar e këshilltarëve pjesëmarrës në mbledhje është pjesë përbërëse e Ekstraktit të procesverbalit.

Neni 56

56.1 Mbledhjet e Kuvendit regjistrohen në mënyrë tonike.

Neni 57

57.1 Ekstrakti i procesverbalit, në parim, miratohet në mbledhjen e radhës të Kuvendit.

57.2 Këshilltari mund të paraqet vërejtje dhe të kërkojë të bëhoni ndryshime dhe plotësime përkatëse në Ekstrakt të procesverbalit. Vërejtjet paraqiten gojarisht dhe dorezohen në formë të shkruar.

57.3 Për arsyeshmërinë e vërejtjeve, sipas paragrafit paraprak të këtij neni, vendoset pa debat.

57.4 Në rast të mospajtimeve eventuale, të qëndrueshme janë vërejtjet të cilat verifikohen në regjistrimin tonik të mbledhjes.

57.5 Ekstrakti i procesverbalit, pas miratimit së bashku me vërejtjet dhe plotësimet eventuale, nënshkruhet nga kryesuesi i Kuvendit përkatësisht kryesuesi i mbledhjes.

#### IV. Rregullat për mbarëvajtjen e punës në mbledhje

##### Neni 58

58.1 Në mbledhje të Kuvendit, askush nuk mund të del në foltore dhe as të diskutoj pa iu dhënë fjala paraprakisht nga kryesuesi i Kuvendit.

##### Neni 59

59.1 Këshilltarët dhe pjesëmarrësit të tjerë në mbledhje, gjatë diskutimeve, janë të obliguar t'i përmbahen çështjes e cila shqyrtohet në kuadër të rendit të ditës, të respektojnë dinjitetin dhe autoritetin e këshilltarëve, udhëheqësve të organeve dhe institucioneve të Komunës, të pranishmëve në mbledhje si dhe personave të tjerë që ndërliken me çështjen për të cilën debatohet.

59.2 Gjatë debatit nuk janë të lejuara shprehjet ofenduese, nënçmuese dhe paraqitja e të dhënave nga jeta private e askujt.

59.3 Gjatë punës përkatësisht debatit, nga këshilltarët dhe pjesëmarrësit të tjerë në mbledhje ndalohet ndërhyrja, ndërprerja apo pengimi në çfarëdo mënyre të diskutuesit përderisa i njëjti e përfundon fjalën e tij.

##### Neni 60

60.1 Në rast se ndonjë prej këshilltarëve apo pjesëmarrësve në mbledhje nuk iu përmbahet rregullave të përcaktuara për mbarëvajtjen e punës së mbledhjes, kryesuesi i Kuvendit, sipas vlerësimit të rastit, mund të shqiptojë masat tërheqje e vërejtjes dhe marrje të fjalës si dhe mund të propozojë masën largim nga mbledhja.

60.2 Masa tërheqje e vërejtjes i shqiptohet këshilltarit dhe pjesëmarrësit tjetër në mbledhje i cili nuk iu përmbahet rregullave të parapara në nenet 59.1, 60.1, 60.2

dhe 60.3 të kësaj Rregulloreje apo në çfarëdo mënyre tjetër e pengon mbarëvajtjen e punës në mbledhjes.

60.3 Masa marrje e fjalës i shqiptohet këshilltarit apo pjesëmarrësit tjetër i cili gjatë diskutimit nuk e përfill masën tërheqje e vërejtjes të shqiptuar nga kryesuesi i Kuvendit dhe me sjelljen e tij vazhdon të shkel rregullat për mbarëvajtjen e mbledhjes.

60.4 Masa largim nga mbledhja i shqiptohet këshilltarit përkatësisht pjesëmarrësit tjetër i cili nuk iu përmbahet masave të shqiptuara nga kryesuesi i Kuvendit tërheqje e vërejtjes ose marrje e fjalës dhe në rastet kur me sjelljet e tyre shkelin dispozitat e kësaj Rregulloreje.

60.5 Për marrjen e masës largim nga mbledhja të këshilltarit apo pjesëmarrësit tjetër vendos Kuvendi, pa debat, me votat e shumicës së këshilltarëve të pranishëm në mbledhje.

60.6 Masa e shqiptuar largim nga mbledhja vlen vetëm për mbledhjen përkatëse.

## V. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit

### Neni 61

#### 61.1 Kryesuesi i Kuvendit,

- a) Thërrat dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit
- b) Në konsultim me kryetarin e Komunës propozon rëndin e ditës për mbledhje të Kuvendit
- c) Kujdeset për organizmin dhe mbarëvajtjen e mbledhjeve të Kuvendit
- d) Përfaqëson Kuvendin
- e) Është përgjegjës për zbatimin e Rregullores së punës të Kuvendit
- f) Kujdeset për koordinimin e punëve të trupave ndihmëse të Kuvendit përkatësisht Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit
- g) Është përgjegjës për transparencën e punës së Kuvendit
- h) Nënshkruan aktet e miratuara në Kuvend
- i) Bashkëpunon me kryetarin e komunës në bashkërendimin e aktiviteteve për punë më të mirëfilltë të Kuvendit

61.2 Kryen edhe punë të tjera në pajtim me dispozitat ligjore, Statutin e Komunës dhe këtë Rregullore.

### Neni 62

62.1 Kryesuesit të Kuvendit , para skadimit të mandatit për të cilin është zgjedhur i pushon funksioni në kushtet e parapara me dispozita ligjore dhe Statutin e Komunës.

62.2 Në rast të pushimit të mandatit , për çfarëdo arsye të kryesuesit të Kuvendit, mbledhja për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit thërret më së largu në afatin prej 30 ditësh nga dita e lirimt të postit përkatës.

62.3 Mbledhjen nga paragrafi paraparak i këtij neni e thërret këshilltari më i vjetër apo këshilltari të cilin e cakton Kuvendi në mbledhjen kur konstatohet pushimi i mandatit të kryesuesit të Kuvendit.

#### **Neni 63**

63.1 Propozimi për mocion përkatësisht votëbesim ndaj kryesuesi të Kuvendit mund të bëhet nga 1/3 ( një e treta) e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve të Kuvendit.

63.2 Propozimi i shtrohet Kuvendit në formë të shkruar me nënshkrim të këshilltarëve përkatës dhe arsyetim të detajuar përse kërkohet votimi për mosbesim.

#### **Neni 64**

64.1 Kryesuesi i Kuvendit, mbledhjen në të cilën do të votohet për mocion të mosbesimit, është i obliguar ta thërret më së largu në afatin prej 30 ditësh nga dita e parashtimit të propozimit.

64.2 Votimi lidhur me çështjen nga paragrafi paraparak i këtij neni bëhet me vota të fshehta.

64.3 Në rast se kryesuesi i Kuvendit nuk e thërret mbledhjen në afatin sipas paragrafit 1 të këtij neni, mbledhjen e Kuvendit e thërret këshilltari më i vjetër në kërkesë të propozuesit për votim lidhur me mosbesim ndaj kryesuesit të Kuvendit.

### **VI. Të drejtat dhe përgjegjësitë e këshilltarit**

#### **Neni 65**

65.1 Këshilltari e ka të drejtën dhe përgjegjësinë e pjesëmarrjes, diskutimit dhe propozimit për shqyrtim të çështjeve të caktuara në mbledhje të Kuvendit me mundësi të barabartë në vendosje dhe ushtrimin e kompetencave në pajtim me dispozitat ligjore, Statutin e Komunës dhe këtë Rregullore.

65.2 Këshilltari mund të kërkojë nga kryesuesi i Kuvendit, kryesuesi i Komiteteve apo Komisioneve të Kuvendit dhe Ekzekutivit informacione dhe sqarime të cilat i nevojiten për ushtrimin e funksionit të këshilltarit.

65.3 Gjithashtu këshilltari e ka të drejtën që në vijimësi të informohet për të gjitha çështjet me rëndësi nga fushëveprimtaria e Kuvendit, Ekzekutivit dhe Komunës në përgjithësi.

65.4 Këshilltari e ka të drejtën e pjesëmarrjes në mbledhjet e të gjitha trupave punuese të Kuvendit, por pa të drejtë vote.

#### Neni 66

66.1 Këshilltarit i lejohet mungesa nga vendi i punës për gjithë kohën apo periudhën kohore të nevojshme për ushtrimin e funksionit të tij në punët dhe aktivitetet e Kuvendit.

66.2 Për ditën apo periudhën kohore në të cilën është i angazhuar në punët dhe aktivitetet e Kuvendit, lidhur me arsyetimin për mungesën e tij në vendin e punës, këshilltarit i fëshohet vërtetimi përkatës.

#### Neni 67

67.1 Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit është e obliguar pjesëmarrja e këshilltarit, përveç rasteve të arsyeshme për mospjesëmarrjen e tij.

67.2 Në rast të pengesave të arsyeshme, këshilltari paraprakisht e njofton kryesuesin e Kuvendit për mospjesëmarrjen e tij në mbledhjen përkatëse të Kuvendit.

#### Neni 68

68.1 Këshilltari është i obliguar të ruajë sekretet dhe të dhënat e natyrës së besueshme që i dërgohen në formë të shkruar si dhe ato për të cilat debatohet në mbledhjet e Kuvendit.

#### Neni 69

69.1 Këshilltarit i jepet kartela identifikuese

69.2 Kartela identifikuese, përveç Emblemsë zyrtare të Komunës, përmban: Emrin, mbiemrin, datëlindjen dhe foton e këshilltarit si dhe datën e lëshimit, afatin e vlerësimorisë dhe numrin e kartelës. ( për këtë merret zyra e personelit dhe MAP )

69.3 Në rast të shuarjes të cilësisë së këshilltarit, i njëjti është i detyruar ta kthejë kartelën identifikuese.

69.4 Evidencën e dhënies së kartelave identifikuese të këshilltarëve e mban Shërbimi profesional i Kuvendit. ( sipas zyrës së personelit dhe MAP)

### VII. Shuarja e mandatit të këshilltarit

#### Neni 70

70.1 Funkzioni i këshilltarit shuhet në pajtim me dispozitat ligjore dhe dispozitat nënligjore.

70.2 Kuvendi konstaton plotësimin e një prej kushteve sipas paragrafit paraparak të këtij neni për shuarjen e mandatit të këshilltarit përkatës.

#### Neni 71

71.1. Në rast të lirimit të ndonjë vendi në përbërjen e Kuvendit, kryesuesi i Kuvendit në afat prej 7 (shtatë) ditë pune e njofton Komisionin Komunal Zgjedhor për iniciimin e procedurës për zëvendësimin e këshilltarit të cilit i ka pushuar mandatin.

71.2 Verifikimi i mandatit të këshilltarit i cili e plotëson vendin e lirë gjatë mandatit përkatës të Kuvendit bëhet në mënyrën e përcaktuar në nenin 8.1 të kësaj Rregulloreje.

### VIII. Konflikti i interesit

#### Neni 72

72.1 Këshilltari përjashtohet nga pjesa e mbledhjes së Kuvendit me rastin e debatit dhe votimit lidhur me çfarëdo çështjesh për të cilat ai apo ndonjë anëtar i familjes së tij të ngushtë kanë ndonjë interes personal apo financiar.

#### Neni 73

73.1 Këshilltari nuk mund të marr pjesë e as të jetë i pranishëm në asnjë fazë përgatitore duke përfshirë punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit në të cilat është anëtar apo Komiteteve dhe Komisioneve në të cilat nuk është anëtar por e ka të drejtën e pjesëmarrjes në mbledhje, që kanë të bëjnë me çështje në të cilat ai apo anëtari i familjes së tij të ngushtë e kanë ndonjë interes personal apo financiar.

73.2 Këshilltari, në rast të konfliktit të interesit, është i obliguar që kryesuesin e Kuvendit ta njoftojë në formë të shkruar në afat prej 3 (tri) ditësh pasi të bëhet në dijeni apo të informohet për çështjen përkatëse.

73.3 Këshilltarët janë të obliguar që në çdo rast, në afatin e përcaktuar në paragrafin paraparak të këtij neni, të paraqesin konfliktin e interesit për këshilltarin tjetër të Kuvendit.

### IX. Grupet e këshilltarëve dhe përfaqësimi politik

#### Neni 74

74.1 Këshilltarët e kanë të drejtën e themelimit të Grupeve të këshilltarëve.

74.2 Grupin e këshilltarëve, në parim, e përbëjnë këshilltarët e një subjekti politik apo të një koalicioni politik.

74.3 Grupi i këshilltarëve përbëhet prej së paku (3) tre këshilltarëve.

74.4 Këshilltari mund të jetë anëtar i vetëm një Grupi të këshilltarëve.

74.5 Grupin e këshilltarëve e përfaqëson shefi i grupit.

74.6 Në mungesë të shefit të Grupit të këshilltarëve të njëjtin e zëvendëson këshilltari të cilit e autorizon Grupi përkatës i këshilltarëve.

74.7 Në rast se Grupi i këshilltarëve përbëhet prej disa subjekteve politike, sipas marrëveshjes, Grupi përkatës mund të përfaqësohet në mënyrë rotative në perioda të caktuara kohore.

74.8 Grupi i këshilltarëve mund të autorizoj një prej këshilltarëve që të njëjtin ta përfaqësoj në çështje të caktuara të cilat shqyrtohen në kuadër të rendit të ditës në mbledhje të Kuvendit, apo në aktivitete të tjera që janë të ndërlidhura me punën e Kuvendit.

74.9 . Përfaqësimi politik i këshilltarëve përbëhet nga një e më shumë këshilltarë por ju grup të këshilltarëve

#### Neni 75

75.1 Kryesuesin e Kuvendit, subjektet politike e njoftojnë në formë të shkruar për përbërjen, përkatësinë partiake apo iniciativave qytetare dhe shefin i cili e përfaqëson Grupin përkatës të këshilltarëve.

75.2 Shefi i Grupit të këshilltarëve në formë të shkruar e njofton kryesuesin e Kuvendit në rast të ndryshimit të përbërjes apo përfaqësimit të Grupit të këshilltarëve.

### X. Trupat punues të Kuvendit

#### Neni 76

76.1 Kuvendi, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiave të veta, në funksion të efikasitetit në lëmi të caktuara për përgatitjen e rekomandimeve akteve të ndryshme dhe dhënien e propozimeve në çështje konkrete në lëmi përkatëse, përveç trupave të përhershëm obligativ, ngritë edhe trupa tjerë punues të përhershëm, të përkohshëm dhe trupa punues ad hoc.

76.2 Trupat e përhershëm punues janë Komitetet obligative, Komitetet e përhershme dhe Komitetet konsultative.

76.3 Trupat e përkohshëm punues dhe trupat ad hoc janë Komisionet, përveç Komisionit për verifikimin e mandateve të këshilltarëve të Kuvendit, Komisioni i cili ka kryesisht karakter teknik.

#### Neni 77

77.1 Komitetet obligative dhe Komitetet e përhershme shqyrtojnë dhe propozojnë politikat e Kuvendit në lëmi të caktuara dhe pas miratimit në Kuvend përcjellin zbatimin e tyre.

77.2 Komitetet japin vlerësime, vërejtje, plotësime dhe sugjerime në materialet të cilat shqyrtohen në Kuvend; propozojnë akte të nevojshme dhe iniciojnë çështje në interes për Komunitetin.

#### Neni 78

78.1 Kuvendi, në funksion të përfshirjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, ngritë Komitetet konsultative për lëmi të caktuara.

78.2 Komitetet konsultative, në lëmi përkatëse, bëjnë hulumtime, japin propozime dhe ofrojnë vlerësime lidhur me iniciativat e Kuvendit të Komunitetit.

#### Neni 79

79.1 Kuvendi, në fillim të mandatit, me vendim të veçantë i ngritë Komitetet e obliguara dhe Komitetet e tjera të përhershme mbi bazën e propozimit të Grupeve të këshilltarëve për numrin, strukturën dhe përbërjen e tyre.

79.2 Struktura e komiteve, nëse nuk parashihet ndryshe me dispozita ligjore dhe dispozita nënligjore, ngritët në proporcion me përqindjen përkatësisht numrin e këshilltarëve të subjekteve politike apo koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend.

79.3 Komitetet, sipas këtij neni, ngritën në kohëzgjatje të mandatit përkatës të Kuvendit.

79.4 Kuvendi, sipas nevojës, mund të ngritë edhe Komitet konsultativ ad hoc.

#### Neni 80

80.1 Këshilltari nuk mund të jetë anëtar i më së shumti dy Komiteteve.

#### Neni 81

81.1 Për propozimin e përbërjes së Komitetit votohet me vota të hapura.

81.2 Komiteti ngritët me vota të shumicës së këshilltarëve të pranishëm në mbledhje.

81.3 Në rast se në votimin e parë nuk miratohet përbërja e propozuar e Komitetit përkatës, votimi përsëritet me mundësi që propozuesit paraprakisht të ndryshojnë propozimet e tyre.

81.4 Nëse në votimin e përsëritur nuk miratohet përbërja e propozuar, kalohet në votim veç e veç për secilin anëtar përkatësisht kryetar dhe zëvendëskryetar të Komitetit përkatës.

81.5 Për anëtarin përkatësisht kryetarin apo zëvendëskryetarin i cili nuk i merr votat e nevojshme, kalohet në propozime të tjera dhe votim në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

#### Neni 82

82.1 Komiteti për Komunitete i zgjedhë Kryesuesin e Komitetit për Komunitete



#### Neni 83

83.1 Posti i liruar i kryetarit, zëvendëskryetarit dhe anëtarit të Komiteteve dhe Komisioneve zëvendësohet nga subjekti apo koalicioni përkatës politik.

#### Neni 84

84.1 Komisionet e përkohshme ngritën për hulumtimin, analizimin dhe identifikimin e zgjidhjeve më funksionale për një apo disa çështje për të cilat është e nevojshme angazhim dhe punë në periudhë të caktuar kohore dhe përgatitjen e propozimeve konkrete për shqyrtim në Kuvend të çështjeve përkatëse.

84.2 Komisionet ad hoc ngritën për vlerësim gjithëpërfshirës të një çështjeje konkrete dhe përgatitjen e propozimit për shqyrtim në Kuvend.

#### Neni 85

85.1 Komisionet e përkohshme dhe Komisionet ad hoc ngritën në analogji me ngritjen e Komiteteve të përhershme dhe mandati i tyre pushon me raskin e miratimit të çështjeve në Kuvend për të cilat janë ngritur.

#### Neni 86

86.1 Në pajtim me dispozitat ligjore, Statutin e Komunës dhe këtë Rregullore miratohet Rregullorja për kompetencat, përgjegjësit dhe punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit.

86.2 Komitetet dhe Komisionet të cilat nuk përfshihen në Rregulloren sipas paragrafit paraprak të këtij neni, përbërja dhe kompetencat e tyre përcaktohen në vendimin me të cilin ngritën.

### XI. Programi i punës i Kuvendit

#### Neni 87

87.1 Kuvendi e miraton Programin e punës për vitin përkatës fiskal

87.2 Në Programin e punës përcaktohen punët dhe angazhimet e Kuvendit, aktivitetet dhe çështjet e parapara për shqyrtim, bartësit e përgatitjes së materialeve dhe afatet e shqyrtimit të tyre.

87.3 Programi i punës së Kuvendit miratohet mbi bazën e propozimit të Programit të punës të kryetarit të Komunës përkatësisht Drejtorive të Komunës duke u mbështetur edhe në propozimet e trupave ndihmës të Kuvendit, Grupeve të këshilltarëve, këshilltarëve të Kuvendit, Grupeve të veçanta të interesit, OJQ-ve dhe subjekteve të tjera relevante të Komunës.

#### Neni 88

88.1 Pas miratimit të Programit të punës, Kuvendi e përcakton kalendarin e mbajtjes së mbledhjeve për vitin përkatës fiskal.

88.2 Datat e caktuara për mbajtjen e mbledhjeve mund të lëvizin më së shumti 7 (shtatë) ditë pune ose me arsyetim të fortë

Neni 89

89.1 Në fillim të çdo viti fiskal e më së largu deri më 31 mars, Kuvendi e shqyrton realizimin e Programit të punës, përkatësisht Raportin e punës për vitin pararendës fiskal.

## XII. Transparenca e punës së Kuvendit

Neni 90

90.1 Puna e Kuvendit është publike, përveç rasteve kur për arsye shprehimish të përcaktuara me dispozita ligjore, Statutin e Komunës apo dispozita të ndonjë akti nënligjor, vendoset që një pjesë apo mbledhja në tërësi të jetë e mbyllur.

Neni 91

91.1 Mbledhjet e Kuvendit në interesim të qytetarëve mund të transmetohen drejtpërdrejt në mënyrën audio dhe video.

Neni 92

92.1 Punët, angazhimet dhe aktivitetet, Kuvendi i Komunës i bënë publike përmes:

- a) Komunikatave
- b) Konferencave për shtyp
- c) Web faqes zyrtare të Komunës
- d) Mjeteve lokale të informimit
- e) Tabelës së shpalljeve, dhe
- f) Buletineve të rregullta dhe periodike

## XIII. Shërbimi profesional i Kuvendit

Neni 93

93.1 Punët profesionale dhe teknike për nevojat e Kuvendit, trupave të Kuvendit, kryesuesit të Kuvendit, Grupeve të këshilltarëve, këshilltarëve, qytetarëve dhe subjekteve të tjera relevante të Komunës, që kanë të bëjnë me punën e Kuvendit, i kryen Shërbimi profesional i Kuvendit. ( Sekretari e Kuvendit )

Neni 94

94.1 Në kërkesë të kryesuesit të Kuvendit, Grupit të këshilltarëve apo këshilltarit, Shërbimi profesional i Kuvendit, jep sqarime në aspektin e zbatimit të dispozitave ligjore, dispozitave nënligjore si dhe ofron ndihmë profesionale e teknike në hartimin e propozimeve të cilat i shtrohen Kuvendit për shqyrtim.

Neni 95

95.1 Shërbimi profesional i Kuvendit e ruan materialin dhe mban evidencë për mbledhjet e mbajtura të Kuvendit dhe trupave të Kuvendit, pjesëmarrjen dhe mungesën e këshilltarëve në mbledhje, diskutimet e bëra, propozimet e miratuara

dhe propozimet të cilat nuk miratohen, çështjet e shqyrtuara si dhe çështje të tjera për të cilat debatohet në mbledhjet e Kuvendit.

**Neni 96**

96.1 Shërbimi profesional i Kuvendit, punët dhe detyrat e punës nga fushëveprimtaria e vet, i kryen në cilësinë e shërbimit të mvehtësishëm në kuadër të Administratës të Komunës.

**XIV. Dispozitat përfundimtare**

**Neni 97**

97.1 Zbatimin e Rregullores e bënë Kuvendi i Komunës.

**Neni 98**

98.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen Rregullat e Punës së Kuvendit për mbajtjen e mbledhjeve, nr. 01-260-08 të datës 29.10.2008.

**Neni 99**

99.1 Kjo rregullore hyn në fuqi së bashku me vendimin , 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

**Obiliq**

22 Maj 2018

Nr - 1/13 -

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**

  
Burim Gërguri